

ATSH

Bujqësia kërkon fonde për zhvillim

Posted on 12:08 - 12 Mars 2014 by Etleva Xhajanka



TIRANE, 12 Mars /ATSH/- “Bujqësia është sektori që pavarësisht krizës ekonomike, ende ruan rritje, ku sipas statistikave, tremujorin e dytë të vitit të shkuar, pati një rritje 3%. Megjithatë ende ky sektor ka potenciale të pasfrytëzuara dhe një nga pengesat për zhvillimin e bujqësisë, ka qenë pamjaftueshmëria e financimeve”.

Kështu deklaroi Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Edmond Panariti, i pranishëm sot në prezantimin e projektit AgroKapital të financuar nga USAID, një program 3 vjeçar që synon të rrisë investimet në bujqësi, veçanërisht në agrobiznes. Ministri Panariti u shpreh se tema e financimit në bujqësi është shumë e rëndësishme.

Lidhur me financimet në këtë sektor, Panariti tha se “kjo situatë vjen edhe për shkak të shkallës së lartë të informalitetit në bujqësi dhe pikërisht për këtë është angazhuar Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Bujqësisë, pra për të formalizuar këtë sektor”. Dhe në këtë drejtim, ai bëri të ditur se “objektivi i parë është iniciativa për të çuar në finale ligjin 7501, për të dhënë certifikatat e para të pronësisë, pasi në këtë mënyrë, hapet tregu i tokës dhe fermerët e kanë më të lehtë për të vendosur tokën si kolateral në bankë dhe për të marrë kredi që të zhvillojnë aktivitetin e tyre”.



Ai deklaroi se dhënia e certifikatave të pronësisë lehtëson procesin e kreditimit të bujqësisë. “Objektiv tjetër i Qeverisë Shqiptare për të zhvilluar sektorin e bujqësisë është orientimi i financimeve në rritjen e zhvillimit. Duhet të heqim dorë nga skemat mbështetëse për bujqësinë e mbijetesës dhe nga skemat që favorizojnë klientelizmin dhe abuzimet. Duhet të ndryshojmë mentalitetin e krijuar deri tani: Bujqësia nuk është sektor që kërkon asistencë sociale, dhe fondet nuk duhet të shkojnë si lëmoshë dhe asistencë për fermerët”, tha ministri.

Më tej, Panariti theksoi se bujqësia kërkon fonde për zhvillim, investim në teknologji moderne, për krijimin e pikave të grumbullimit, magazinave frigoriferike etj. "Konkretisht Ministria e Bujqësisë synon të sjellë risi në skemat e reja të mbështetjes me financimin e teknologjive të reja që rrisin rendimentin dhe janë miqësore me mjedisin. Në serat me ngrohje synojmë që nafta të zëvendësohet me alternativa të tjera psh me gaz duke shfrytëzuar dhe projektin TAP që do të kalojë në vendin tonë. Në këtë këndvështrim, Ministria e Bujqësisë i bën thirrje gjithë investitorëve, donatorëve, bankave të orientojnë fondet pikërisht drejt zhvillimit të sektorit të bujqësisë", përfundoi fjalën e vet Ministri Panariti. Programi Agro capital, i financuar nga USAID dhe zbatuar nga Creative Business Solution, synon që brenda tre viteve të investojë 18.5 mln dollarë dhe të hapë 1150 vende të reja pune në sektorin e bujqësisë.e.xh/.a.g/